



Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova  
Kosovo Chamber of Physiotherapists

**RREGULLORE**  
**PËR**  
**EDUKIMIN E VAZHDUESHËM PROFESIONAL TË**  
**FIZIOTERAPEUTËVE NË OFTK**



Prishtinë, Dhjetor 2023

Adresa: Kompleksi i Q.K.U.K, Klinika e Mjeksisë Fizikale me Rehabilitim, Kati i I-rë, RKS-10000.  
Address: UCCK Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1<sup>st</sup> Floor, RKS-10000.  
Tel +383(0) 45 460 551; e-mail [info@oftk-ks.org](mailto:info@oftk-ks.org); web : [www.oftk-ks.org](http://www.oftk-ks.org)

Oda e  
Fizioterapeutëve  
të Kosovës





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

KUVENDI I ODËS SË FIZIOTERAPEUTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, Nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë Nr. 04/L-150 dhe nenit 20, paragrafi 1, Nenin 15, paragrafi 7 të Statutit të Odës së Fizioterapeutëve të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22.12.2023, miraton plotësim ndryshimet e:

### RREGULLORE

#### PËR

#### EDUKIMIN E VAZHUESHËM PROFESIONAL

(Tekst i spastruar me plotësime dhe ndryshime sipas Vendimit të Kuvendit të OFTK-së nr.602, dt.22.12.2023)

### KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1

#### Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, llojet, programet dhe procedurat e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (në tekstin e mëtejshëm EVP), akreditimi i programeve të EVP-së, përkrahja financiare për profesionistët shëndetësorë dhe shoqatave profesionale që organizojnë aktivitete të EVP-së, vlerësimin e të gjitha formave të EVP-së si dhe çështje tjera të rëndësishme që ndërlidhen me EVP.

#### Neni 2

#### Fushëveprimi

1. Kjo rregullore zbatohet ekskluzivisht për mbikëqyrjen, vlerësimin dhe përkrahjen e aktiviteteve të EVP-së për profesionistët në lëmin e fizioterapisë, si dhe për valorizimin e pikëve kredituese për rilcencim të profesionistit shëndetësor nga lëmia e fizioterapisë.
2. EVP i fizioterapeutëve përfaqëson një proces të vazhdueshëm të përvetësimit të njohurive të reja dhe aftësive të reja praktike, në përputhje me trendet e zhvillimit të profesionit dhe shkencës fizioterapeutike, që është e drejtë dhe detyrim i çdo fizioterapeuti. Qëllimi i EVP është të zbatojë njohuri të reja në praktikë, me qëllim të ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së punës së fizioterapeutëve.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

#### Neni 3 Përkufizimet

Termet dhe akronimet e përdorura në tekstin e kësaj rregulloreje, kanë këto kuptime:

1. **EVP** – nënkupton Edukimin e Vazhdueshëm Profesional; EVP është proces nëpërmjet të cilit profesionistët e shëndetësisë përditësojnë dijet dhe aftësitë e tyre, me qëllim të ofrimit sa më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.
2. **Aktivitetet e EVP-së** – nënkupton aktivitetet e organizuara nga institucionet shëndetësore, shoqatat profesionale ose subjektet tjera të përcaktuara me këtë rregullore, që kanë karakter profesional dhe që organizohen me qëllim të ngritjes së vazhdueshme profesionale të fizioterapeutëve;  
Disa nga format e EVP janë: Kongresi, Konferenca, Seminari, Simpoziumet, Ligjëratat, dhe format tjera të përcaktuara me këtë rregullore.
3. **Valorizimi i pikëve kredituese** – nënkupton sistemin e vlerësimit të aktiviteteve që ndiqen nga profesionistët shëndetësorë për qëllime të EVP-së;
4. **Oda** – nënkupton Odën e Fizioterapeutëve të Kosovës - OFTK;
5. **Komisioni për EVP** – nënkupton organin kompetent të Odës i cili zbaton, mbikëqyrë, planifikon dhe vlerëson aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm profesional dhe valorizimin e pikëve kredituese për rilicencim të profesionistit shëndetësor nga lëmia e fizioterapisë.

#### Neni 4 Përbërja dhe funksionimi i Komisionit për EVP

1. Komisioni për EVP (në tekstin e mëtejme: KEVP) është organi i Odës, që përbëhet prej 5 (pësë) anëtarëve që janë të zgjedhur nga Kuvendi i Odës, në përputhje me dispozitat e Statutit të Odës dhe akteve normative të Odës.
2. Mandati i KEVP rregullohet me Rregulloren për Zgjedhjen e Organeve të OFTK-së.
3. Puna dhe procedurat e vendimmarrjes së KEVP-së janë të rregulluara me Rregulloren e Punës së Organeve të OFTK-së.

#### Neni 5 Definicionet mbi aktivitetet të EVP-së

1. EVP përbëhet nga aktivitete shkencore dhe edukative që shërbejnë për të ruajtur, zhvilluar ose rritur njohuritë, aftësitë dhe arritjet profesionale të cilat fizioterapeuti i shfrytëzon për t'i ofruar shërbime profesionale pacientëve, shoqërisë dhe profesionit. Aktivitetet e EVP përfshijnë:

- 1.1 Studimet pasuniversitare dhe aftësimet profesionale të fizioterapeutëve: studimet master, specializimin, studimet e doktoraturës.







## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

1.2 Pjesëmarrjen në kongrese, konferenca, simpoziume dhe forma të tjera të takimeve profesionale, pjesëmarrjen në kurse, seminare, qëndrime studimore, publikim të artikujve në revista profesionale, shkencore ose botime tjera, mësim në distance (online) etj.

2. Me qëllim të unifikimit të terminologjisë së aktiviteteve të EVP-së dhe zbatimit të kësaj rregulloreje, me dispozita të këtij neni disa nga termet kanë këtë kuptim:

2.1. **Kongresi** - është takim i një numri të madh të shkencëtarëve dhe ekspertëve të organizuar sipas një programi të përcaktuar për të diskutuar tema profesionale dhe shkencore. Punimet e prezantuara në kongres publikohen në përmbledhjen e punimeve, përmbledhjen e abstrakteve apo në revistë profesionale. Karakteristikë e Kongresit është se zgjasin 2 (dy) e më shumë ditë dhe përsëritet brenda periudhave të caktuara.

2.2. **Konferenca** – është një takim formal ku pjesëmarrësit shkëmbejnë pikëpamjet e tyre mbi tema të caktuara dhe ku ekspert të fushës prezantojnë ligjërata ose studime e reja. Konferenca mund të zgjasë 2 (dy) ose më shumë ditë me diskutime formale që zhvillohen sipas rendit të ditës të konferencës dhe ndahet në seanca. Një seancë përmbanë 4-6 prezantime që zgjasin deri në 2 orë. Pas përfundimit të seancës, organizohet debat lidhur me temat e prezantuara

2.3. **Simpoziumi** - është takim i kohëpaskohshëm shkencor - profesional i ekspertëve për të debatuar për një temë saktësisht të përcaktuar, që mund të zgjasë një ose më shumë ditë. Simpoziumi është një formë e zhvillimit profesional, ku ekspertët dhe specialistët nga një fushë specifike ofrojnë njohuri për të njëjtën temë, me rekomandime dhe përmes diskutimit.

2.4. **Seminari** - është aktivitet i EVP-së në kuadër të cilit shtjellohet në aspektin teorik një temë e caktuar ku së paku 30 % e kohëzgjatjes së seminarit i kushtohet diskutimit interaktiv në mes ligjëruesit dhe pjesëmarrësve. Seminarët janë takime të një grupi të vogël pjesëmarrësish dhe që nuk zgjasin zakonisht me shumë se një ditë.

2.5. **Kurs/trajnim** - paraqet një formë të përvetësimit të njohurive, aftësive të reja përmes ligjëratave teorike – praktike në grupe të vogla, me temë të caktuar paraprakisht.

Kurset janë të organizuara me një program specifik për çështje specifike, të përbërë nga disa komponentë arsimore: ligjërata, diskutime, punë praktike, lexim, hulumtime laboratorike gjatë një periudhe një ose disaditore me nga 2 - 5 orë (ose më shumë) me informacione dhe mbështetje adekuate.

2.6. **Punëtori** – Është aktivitet me një grup pjesëmarrësish prej 10-30 veta. Qëllimi është përfshirja aktive e pjesëmarrësve në diskutime dhe zgjidhjen e problemeve, në kryerjen e një teknike, procedure apo manipulimi të ndihmuar nga eksperti/trajneri. Drejtohet nga trajneri ose moderatori. Një seancë punëtorie zgjatë jo më pak se 90 minuta.

2.7. **Të mësuarit në distance/online** – janë aktivitete të EVP-së që kryhen në mënyrë të pavarur nga ana e profesionistit shëndetësor me ndihmën e teknologjisë moderne. Videokonferencat, uebseminaret, webkonferencat dhe format e tjera të komunikimit nëpërmjet teknologjisë informative, e lejojnë profesionistin shëndetësor të ndjekë një program trajnimi me interes për të, pa pasur nevojë për prezencë fizike. Çdo kurs në internet duhet të





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

përmbajë një kontroll të njohurive. OFTK mund të zhvillojë një kurs në internet me palën e interesuar që plotëson kërkesat teknike dhe profesionale.

2.8. **Takimet profesionale** – mund të organizohen brenda institucionit shëndetësor dhe përfshijnë ligjëratë për të paktën 1 orë për një temë të caktuar dhe diskutime për të njëjtën temë. Takimet profesionale duhet të lajmërohen paraprakisht në Komisionin për EVP, të paktën 20 ditë para mbajtjes së tyre.

2.9. **Shkolla verore** - është një formë e formimit edukativ, i cili zhvillohet gjatë verës për disa javë për të fituar njohuri të reja praktike dhe profesionale.

3. Karakteri kombëtar apo ndërkombëtar i një aktiviteti të EVP-së përcaktohet në bazë të pjesëmarrjes të ekspertëve dhe shkencëtarëve. Një aktivitet i EVP në Kosovë mund të marrë karakterin ndërkombëtarë nëse të paktën  $\frac{1}{4}$  e Komitetit shkencor dhe/ose  $\frac{1}{4}$  e pjesëmarrësve aktiv (ligjërues, autor) janë nga vendet tjera, dhe prezantimet e tyre kryhen në gjuhën angleze.

4. Aktivitet e EVP-së në mënyrë që të akreditohen duhet të mbulojnë fushat e mëposhtme:

- Fizioterapisë
- Mjekësisë dhe fushave tjera relevante shëndetësore

5. Mënyra e akreditimit të aktiviteteve të EVP-së në mënyrë të detajuar do të jepet në Shtojcën I – Sistemi i akreditimit të aktiviteteve të EVP-së.

#### Neni 6

#### Ushtrimi i funksionit të EVP-së

1. Mbikëqyrjen dhe aranzhimin e aktiviteteve të EVP-së, e ushtron KEVP, si komision i përhershëm i OFTK-së
2. KEVP në ushtrim të këtij funksioni publik, do të ketë këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - 2.1. zbatimi i procedurave të veçanta administrative për evidentimin e EVP-së;
  - 2.2. krijimi i kushteve dhe stimulimi i sponsorizimit të aktiviteteve të EVP-së;
  - 2.3. zbatimi i buxhetit të Odës për përkrahjen e pjesëmarrjes në aktivitete të EVP-së nga anëtarët e OFTK-së;
  - 2.4. zbatimi i buxhetit të Odës për përkrahjen e organizimit të aktiviteteve të EVP-së;
  - 2.5. akreditimi i aktiviteteve të EVP-së;
  - 2.6. akreditimi i planeve vjetore dhe programeve për EVP;
  - 2.7. valorizimin e pikëve të fituara nga anëtarët e OFTK-së për nevojat e ri licencimit;
  - 2.8. menaxhimin e regjistrimit të aktiviteteve të EVP-së;
  - 2.9. kryen edhe funksione të tjera sipas nevojave për plotësimin e qëllimit të kompetencës publike për EVP, të bazuar në legjislacionin në fuqi dhe akteve të brendshme normative të OFTK-së.







## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

#### KAPITULLI II AKREDITIMI I AKTIVITETEVE

##### Neni 7

#### Subjektet e autorizuara për akreditim të planeve vjetore, programeve dhe aktiviteteve të EVP-së

1. Në cilësinë e subjekteve të autorizuara për procesin e akreditimit të planeve vjetore, programeve dhe aktiviteteve të EVP-së, janë:

- 1.1. Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës
- 1.2. Shoqatat Profesionale të Fizioterapeutëve/Profesionistëve tjerë Shëndetësorë
- 1.3. Institucionet e kujdesit shëndetësor;
- 1.4. Institucionet e arsimit të lartë të akredituara nga organi kompetent i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- 1.5. Subjektet biznesore/fitimprurëse që kanë veprimtarinë e regjistruar të ndërlidhur me fushën e fizioterapisë/mjekësisë;
- 1.6. Personat e tjerë fizikë dhe juridikë me kusht që të janë të licencuar për aftësim profesional

##### Neni 8

#### Procedura e akreditimit të planit vjetor dhe aktiviteteve të EVP-së

1. KEVP në kuadër të përpilimit të planit dhe programit vjetor për EVP do t'i propozojë Këshillit Drejtues të OFTK-së, të organizojë aktivitete për qëllime të EVP-së, të paktën 2 (dy) herë në vit me ç'rast do të përmbushë minimumin e pikëve të nevojshme për rilicencim të anëtarëve të saj.
2. Subjektet nga neni 7 të cilët dëshirojnë të akreditojnë plane vjetore, planet për aktivitete duhet të dorëzojnë KEVP-së më së largu deri më 30 nëntor të vitit paraprak. Subjektet që nuk respektojnë afatit, humbin të drejtën për akreditimin e aktiviteteve.
  - 2.1. përmbajtja e kërkesës së planit vjetor duhet të specifikojë numrin e aktiviteteve të cilat planifikohen të mbahen, dhe temat që do të prezantohen në të brenda vitit.
  - 2.2.përmbajtja e planit vjetor për aktivitete të organizuara nga OFTK aprovohet nga Këshilli Drejtues.
  - 2.3.aktivitetet e akredituara duhen të jenë në fushën e Fizioterapisë.
3. KEVP mund t'i propozojë Këshillit Drejtues të OFTK-së që aktivitetet e tilla t'i organizojë në bashkëpunim me ndonjërin nga subjektet e autorizuara sipas nenit 7.
4. Pjesëmarrja në aktivitete që janë të organizuara nga OFTK-ja mund të kufizohet në pjesëmarrjen vetëm të anëtarëve të Odës, në raste të caktuara me arsyetim profesional.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

#### Neni 9

#### Dokumentet e nevojshme për akreditim të aktiviteteve të EVP

1. Subjektet e autorizuar për organizim mund të parashtrijnë kërkesë për akreditim të aktivitetit të EVP-së pranë Komisionit për EVP.
2. Aplikuesit për akreditim të aktivitetit të EVP-së, janë të obliguar t'i dorëzojnë dokumentet si në vijim:
  - 2.1. Aplikacionin e akreditimit të plotësuar në mënyrë elektronike, të nënshkruar dhe vulosur me vulë përkatëse; Shtojca – Aplikacioni për akreditim të aktiviteteve të EVP-së në fuqi, e miratuar nga Kuvendi i OFTK-së;
  - 2.2. Programin e hollësishëm të aktivitetit duke përfshirë përcaktimin e objektivave, përmbajtjes, metodologjisë, orarin dhe vendin e mbajtjes së aktivitetit;
  - 2.3. Çertifikatë e regjistrimit të subjektit;
  - 2.4. Dëshminë e pagesës së taksës administrative në xhirologarinë e OFTK-së;
  - 2.5. Raportin e këshillit shkencor me listën e ligjruesëve/autoreve me CV ose shkallen akademike dhe institucionin ndërlidhës dhe temat/abstraktet e përcaktuara për ligjërime.
3. Dështimi për të plotësuar dokumentacionin e përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, paraqet bazë për refuzimin e akreditimit të aktivitetit.
4. Vetëm aplikacionet e kompletuara do të merren në shqyrtim nga ana e KEVP.
5. Subjekti është i obliguar që të aplikojë të paktën 45 ditë para datës së mbajtjes së aktivitetit.
6. Asnjë aplikim jashtë këtij afati nuk do të shqyrtohet nga ana e KEVP.
7. Brenda 15 ditëve pas aplikimit KEVP shqyrton aplikacionin me dokumentacionin përkatës dhe në rast të akreditimit të planit dhe programit lëshon vendim me të cilën akreditohet aktiviteti i EVP-së.
8. Në rast të refuzimit të akreditimit të programit, ose subjektet e pakënaqura me vendimin e KEVP mund të paraqesin ankesë pranë Këshillit Drejtues të Odës në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimi të vendimit.

#### Neni 10

#### Kriteret financiare për akreditim të aktivitetit për EVP

1. Me rastin e aplikimit për akreditim të aktiviteteve të EVP, subjektet duhet të paguajnë taksën administrative si në vijim:
  - 1.1. Kongreset dhe konferencat pa pjesëmarrje ndërkombëtare - pagesa prej 400.00 euro;
  - 1.2. Kongreset dhe konferencat me pjesëmarrje ndërkombëtare - 500.00 euro;
  - 1.3. Simpoziumet dhe seminarët pa pjesëmarrje ndërkombëtare — 200.00 euro;
  - 1.4. Simpoziumet dhe seminarët me pjesëmarrje ndërkombëtare — 300.00 euro;
  - 1.5. Kurse/trajnime pa pjesëmarrje ndërkombëtare — 300.00 euro;
  - 1.6. Kurse/trajnime me pjesëmarrje ndërkombëtare — 350.00 euro;
  - 1.7. Punëtoritë/workshop-et pa pjesëmarrje ndërkombëtare — 200.00 euro
  - 1.8. Punëtoritë/workshop-et me pjesëmarrje ndërkombëtare — 250.00 euro
  - 1.9. Takimet profesionale — 50.00 euro;







## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

- 1.10. Të mësuarit online në sistemin e lansuar nga OFTK – për individ 20.00 euro
- 1.11. Aktivitetet e organizuara nga Kompanitë prodhuese ose qarkulluesit fizioterapeutik me shumicë (ortopedike, mjekësore, etj) - 700.00 euro.
2. Subjektet e akredituara paguajnë 10% të kuotizimit të caktuar nga ta për pjesëmarrje, certifikatat e të cilëve dorëzohen në OFTK për nënshkrim.
  - 2.1. Subjektet të cilat organizojnë aktivitetet jo-fitimprurëse janë të lira nga taksat administrative të përcaktuara me këtë nen
3. Taksa administrative e paraparë nga ky nen shërbejnë për iniciimin e procedurës së akreditimit të aktivitetit.
4. KEVP nuk lëshon vendim për akreditim pa paguar taksën administrative sipas paragrafit 1 të këtij neni.

#### Neni 11

##### Akreditimi i programeve nga subjektet e jashtme

1. Komisioni i EVP-së shqyrton kërkesën për akreditim të subjektit të jashtëm të autorizuar për akreditim të aktiviteteve nga OFTK në afat prej 30 ditësh.
2. Komisioni i EVP-së ndaj kërkesës për akreditim merr vendim:
  - 2.1. Vendim për akreditim të programit – Ndaj subjektit i cili përmbush të gjitha kriteret dhe kushtet për kreditim sipas kësaj Rregullore.
  - 2.2. Vendim për refuzim të akreditimit të programit – Në rast se subjekti nuk ka përmbushur kriteret dhe kushtet e parapara në rregullore.
3. Komisioni i EVP-së akrediton programin me pikët vlerësuese (pjesëmarrje pasive dhe aktive) sipas Shtojcës së EVP-së të miratuar në Kuvendin e OFTK-së.
4. Pas marrjes së vendimit për akreditim nga OFTK, Subjekti i autorizuar informohet në lidhje me vendimin e marr të KEVP-së
5. Ndaj subjektit të cilit i është refuzuar kërkesa për akreditim, subjekti ka të drejtën e ankesës drejtuar Këshillit Drejtues në afat prej 8 ditësh drejtuar Këshillit Drejtues të OFTK.

#### Neni 12

##### Kriteret e formës dhe mënyrës së lëshimit të certifikatave për aktivitetet e EVP-së

1. Certifikata e pjesëmarrjes në aktivitetet e akredituara nga OFTK-ja, mund të lëshohet vetëm në përfundim të aktivitetit.
  - 1.1. Certifikatat duhet të jenë të shtypura në formatin standard A4.
  - 1.2. Certifikatat duhet të përmbajnë logon zyrtare të OFTK-së e cila vendoset në këndin e sipërm të djathtë të certifikatës. Në këndin e poshtëm të djathtë duhet të përmbajë vendin për nënshkrimin e kryetarit të KEVP, në emër të KEVP-së ndërsa në anën e majtë të organizatorit të Aktivitetit.







## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

1.3. Çertifikatat në të cilat organizator është vetëm OFTK-ja, përmbajnë në qendër logon e Odës, ndërsa në këndin e majtë poshtë vendin për nënshkrim të kryetarit të OFTK-së, ndërsa në këndin e djathtë poshtë vendin për nënshkrim të kryetarit të KEVP.

1.4. Certifikata duhet të përmbajë në tekstin e saj emërtimin e plotë të aktivitetit, emërtimin e organizatorit, datën edhe vendin e mbajtjes dhe pikët kredituese, duke specifikuar pjesëmarrjen (aktiv ose pasiv).

1.5. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara nga EVP/OFTK certifikata për nënshkrim nga Kryetari/ja e EVP/OFTK duhet të përmbajë titullin ‘‘Certifikatë Pjesëmarrje’’

2. Subjekti zbatues i aktivitetit të akredituar është i obliguar që certifikatat t’i dorëzoj pranë KEVP së bashku me listën e nënshkruar të pjesëmarrësve, më së largu 10 ditë pas përfundimit të aktivitetit.

2.1. Një kopje e listës së pjesëmarrësve i bashkangjitet dosjes së aplikimit dhe e njëjta nënshkruhet nga kryetari i KEVP-së, duke specifikuar edhe numrin e certifikatave të nënshkruara për aktivitetin në fjalë.

2.1.2 Pjesëmarrësit e programit të përfshirë në Listë, i regjistrohen pikët e pjesëmarrjes në sistemin elektronik.

#### Neni 13

#### Mbikëqyrja e aktiviteteve

1. KEVP do të mbikëqyrë zbatimin e planit të akredituar përmes mbikëqyrjes së aktivitetit nga ana e njërit prej anëtarëve të KEVP-së, apo edhe me kontaktet e drejtpërdrejta të Komisionit me përfaqësuesin e subjektit që zbaton planin dhe programin e akredituar.
2. Në rast se subjekti i cili zbaton planin dhe programin e akredituar nuk i përmbahet përshkrimeve për të cilat është lëshuar vendimi për akreditim, KEVP mund do të revokojë vendimin dhe aktivitetet do të konsiderohen si të pa akredituara.
3. Në rast të mosrespektimit të kritereve të përcaktuara me këtë rregullore, KEVP mund të ndërmarrë masa me gjobë ndërsa me rast të përsëritjes së shkeljes së njëjtë shqiptimi i masës së ndalimit për akreditim të aktiviteteve me periudhë prej 1 vjeçare. Masa e tillë do të evidentohet në regjistrin e EVP të cilin e mirëmbanë KEVP.
4. Ne ueb faqen e OFTK-së do të publikohet regjistri me aktivitetet e akredituara i përditësuar.
  - 4.1. Revokimi i akreditimit do të evidentohet gjithashtu në Regjistrin e aktiviteteve të EVP-së.
5. Aktivitetet e vijua deri në revokim të vendimit do të konsiderohen si të akredituara.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

#### Neni 14

#### Vlerësimi i aktivitetit

1. Secili aktivitet i akredituar duhet t'i nënshtrohet vlerësimit. Procesin e vlerësimit të brendshëm e realizon vet organizatori i aktivitetit dhe kjo shërben si bazë për vlerësimin e jashtëm të aktivitetit. Gjatë vlerësimit të aktivitetit, organizatori duhet të dëshmojë se janë përmbushur objektivat dhe pritshmërit nga organizimi.

2. Vlerësimi i pikëve kredituese nga Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional për arritjet shkencore dhe studimet profesionale pas diplomike bëhet sipas Vlerësimit të Pikëve Kredituese të miratuara nga Kuvendi i OFTK-së

3. Në rast të ndryshimit të ligjëruesve dhe trajnerëve (ose datës së mbajtjes së aktivitetit) nga ata të deklaruar në dosjen e aplikimit, ofruesi duhet të paraqesë një sqarim me shkrim pranë KEVP të paktën 7 ditë para mbajtjes së aktivitetit, duke dëshmuar ekspertizën e personit të përzgjedhur. Ndërrimi i renditjes së temave ose sesioneve mund të lejohet, nëse nuk cenohet kohëzgjatja dhe lidhja logjike mes temave.

KEVP do të njoftojë organizatorin nëse ndryshimet e paraqitura ndikojnë në procesin e akreditimit.

4. Ofruesi duhet të regjistroj të gjithë pjesëmarrësit në aktivitet, duke mos lejuar regjistrimin e personave që nuk janë të pranishëm në aktivitet ose regjistrimin pas fillimit të aktivitetit. Regjistrimi mund të kryhet vetëm në periudhën të cilën paraprakisht e deklaroi organizatori dhe duhet të jetë i tillë që duhet të mundësoj përcjelljen e të gjithë aktivitetit, ose seancave të caktuara, nëse akreditimi është bërë ndaras për secilin seancë.

5. Vlerësimi i jashtëm kryhet nga ana e KEVP, Vlerësimi i aktivitetit nga ana e KEVP kryhet në dy faza dhe përfshinë fazën e akreditimit të aktivitetit pas shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit dhe fazën e monitorimit dhe vlerësimin përfundimtar. Gjatë fazës së dytë të monitorimit dhe vlerësimit përfundimtar, kur KEVP e sheh të arsyeshme, cakton një grup prej 2 (dy) anëtarësh (anëtarë të KEVP-së) të cilët mund të bëjnë monitorimin, vlerësimin e mbarëvajtjes së aktivitetit, duke përfshirë monitorimin dhe regjistrimin e: rendit të ditës të deklaruar, listën e ligjëruesve/trajnerëve, listën e pjesëmarrësve, kohëzgjatjen e ligjëratave dhe temat e deklaruara.

6. KEVP do të informojë organizatorin me përbërjen e grupit monitorues të paktën 5 ditë para fillimit të aktivitetit në mënyrë të lejimit të pjesëmarrjes mbikëqyrëse.

7. Anëtarët gjegjësisë të caktuar për monitorim 15 ditë nga përfundimi i aktivitetit do të i'a dorëzoj një raport me shkrim KEVP, duke specifikuar nëse organizatori i ka përmbushur dhe i është përmbajtur programit të deklaruar, sa i përket temave, ligjëruesve dhe orarit, si dhe duke specifikuar numrin e pjesëmarrësve dhe kohën e mbylljes së







## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

listës së regjistrimit të pjesëmarrësve. Nëse anëtarët vërejnë regjistrime pas fillimit të aktivitetit/ligjëratave, atëherë mund të nënshkruaj listën e pjesëmarrësve tek numri rendor ku vlerëson se janë bërë regjistrime jashtë afatit.

8. KEVP ka të drejtë të monitorojë në çdo kohë, edhe në mënyrë të rastësishme dhe pa njoftim paraprak aktivitetin e EVP-së të akredituar ose në procedurë të akreditimit, për të siguruar zbatimin e standardeve dhe kriterëve të parashikuara.

### KAPITULLI III AFTËSIMI PROFESIONAL

#### Neni 15

#### Obligimi i fizioterapeutëve për aftësim të vazhdueshëm profesional dhe portofolin personale e EVP-së

1. Anëtari i Odës, respektivisht Fizioterapeuti, është i obliguar që t'i nënshtrohet EVP-së në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e kujdesit fizioterapeutik dhe të plotësoj kushtet për ri licencim.
2. Anëtar i Odës është i obliguar që brenda 5 (pesë) viteve të grumbullojë në total 100 (njëqind) pikë për pjesëmarrje në aktivitetet e EVP-së.
3. Aplikuesit nga 100 piket e kërkuara për ri licencim, së paku 70% të pikëve duhet të jenë nga fusha profesionale e fizioterapisë ndërsa pjesa tjetër e pikëve mund të jenë nga fushat tjera të mjekësisë.
  - 3.1. Vlerësimi i pikëve nga fushat e tjera të mjekësisë mbetet në diskrecion të komisionit.
4. Niveli i tolerancës nga kriteri pikës 2 është 5% e pikëve.
5. Aplikuesit për valorizim për certifikatat e trajnimeve online kanë të drejtë që brenda 5 viteve të marrin 25 pikë kredituese. Një certifikatë online mund të merr maksimumin 5 pikë kredituese dhe aplikuesi duhet të ketë vërtetësi të certifikatës së paraqitur.
  - 5.1. Përrjashtimisht nga paragrafi 5, Aplikuesit për periudhën kohore nga 13 Mars 2020 në vazhdim të periudhës kohore edhe të vitit 2021 të pandemisë COVID 19 do ti njihen jo më shumë se 20 pikë kredituese për vit nga trajnimet online të mbajtura në këtë periudhë.
  - 5.2. Nëse një anëtarë i Odës me pjesëmarrjen në EVP brenda një viti përmes trajnimeve online arrin me shume se 25 pike, ne baze te listës se pikëve, ato pike nuk do ti njihen ne vitin e ardhshëm.
6. Aplikuesit nga institucionet publike shëndetësore (niveli primarë, sekondarë dhe terciarë) mund të marrin maksimum 25 pikë brenda 5 viteve për dëshmitë e mbledhjeve dhe takimeve profesionale.
7. Valorizimi i pikëve kredituese është kompetencë ekskluzive e KEVP. Valorizimi i pikëve për pjesëmarrje në aktivitete të EVP-së do të bëhet sipas Shtojcës – Tabela për Valorizimi i Pikëve Kredituese, në të cilën janë përcaktuar pikët kredituese për secilin lloj të aktivitetit.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

8. Me rastin e valorizimit të pikëve, KEVP lëshon vendim në të cilën konstaton valorizimin e pikëve.
9. Pala e pakënaqur me vendimin për valorizim, ka të drejtë ankese pranë Këshillit Drejtues në afat prej 7 (shtatë) ditë nga dita e pranimit të vendimit për valorizim.

#### Neni 16

##### Mënyra e llogaritjes së pikëve

1. Anëtari i Odës është i obliguar të marrë pjesë në aktivitete të EVP-së në mënyrë që për çdo vit të fitojë së paku 5 (pesë), duke e llogaritur nga data e lëshimit të licencës së fundit për punë.
2. KEVP ka të drejtën e llogaritjes së certifikatave të lëshuara jashtë shtetit të Kosovës vetëm në rast se të njëjtat janë të njohura nga shteti amë apo organi gjegjës kompetent i tyre.

#### Neni 17

##### Inicimi i procedurës për valorizim të pikëve

1. Anëtari i Odës inicion procedurën e Ri-licencimit jo më larg se 30 ditë para skadimit të licencës përmes parashtrimit të kërkesës për ri licencim në platformën online.
2. Valorizimi i pikëve kredituese nga KEVP është faza e parë e brendshme e procedurës së Ri-licencimit të anëtarëve të OFTK-së.
3. Nëse Fizioterapeuti për shkaqe të justifikuara (pushim mjekësor për më shumë se gjashtë muaj, shtatzënia dhe komplikimet lidhur me mbajtjen e shtatzënisë, etj.), nuk i ka plotësuar kërkesat nga neni 15, paragrafi 1 dhe 2 kësaj Rregulloreje, KEVP mund ta liroj aplikuesi nga obligimi për pikët kredituese për periudhën e cekur, por jo më shumë se 1 (një) vit.
  - 3.1. Për rastet e përcaktuara në paragrafin 3, KEVP mund ta liroj aplikuesi nga obligimi për 20 pikët kredituese për periudhën e cekur, por jo më shumë se 1 (një) vit me përjashtim të rasteve të shtatzënisë. Periudha e shtatzënisë nënkupton periudhën nga muaji i 6 i shtatzënisë.
4. Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse arsyet e justifikuara nga paragrafi 3 i këtij neni zgjasin më shumë se një vjet, Fizioterapeuti aplikon në KEVP për përjashtim nga marrja e pikave të nevojshme. KEVP e dërgon kërkesën në Këshill Drejtues të OFTK-së për vendimmarrje. Kërkesat duhet të dokumentohen me arsyet e parandalimit të përcjelljes së EVP-së.
5. KEVP ndaj kërkesës për Ri-licencim, ne valorizimin e pikëve kredituese ka të drejtën e marrjes së vendimit aprovues apo refuzues. dhe vendimit. për rishqyrtim.
6. Ndaj anëtarit/es i cili nuk arrin pikët e nevojshme për valorizim, Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional merr vendim refuzues dhe këshillon anëtarin nënshtrimin për Provim të Ri-licencimit.
  - 6.1. Afati kohor për përcaktimin e provimit të Ri-licencimit nga anëtari fillon 7 ditë nga data e hyrjes së vendimit për refuzimin e kërkesës së valorizimit për Ri-licencim (kalimi i afatit kohorë për ankesë).







## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

6.2. Nëse pala në afatin prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e vendimit mbi refuzimin e pikëve kredituese, aplikon për provimin e ri licencim konsiderohet se i njëjti është në vazhdimësi të procesit për ri licencim.

7. Anëtarët e Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional të OFTK-së kanë të drejtën e marrjes së vendimit për rishqyrtim ndaj anëtarit/ës me afat prej 7 ditëve pune kur:

7.1. Anëtari duhet të sjellë vërtetime të origjinalit ndaj certifikatave të dorëzuar ne Komision.

7.2. Anëtari është afër arritjes së pikëve të nevojshme për valorizim andaj Komisioni i EVP-së jep afat shtese për sjelljen e Certifikatave të tjera.

8. Anëtari/ja i cili arrin pikët e nevojshme për valorizim, KEVP merr vendim aprovues përmes të cilit anëtari/ja automatikisht procedohet në fazat e mëtejme të rregullta për Ri-licencim.

## KAPITULLI IV – PËRKRAHJA PËR ORGANIZIM DHE PJESËMARRJE NË EVP

### Neni 18

#### Përkrahja e anëtarëve të OFTK-së për pjesëmarrje në aktivitetet e EVP-së

1. Fizioterapeutët në cilësi të personave fizik kanë të drejtë që të aplikojnë për përkrahje në pjesëmarrje në aktivitete të EVP-së me plotësimin e kushteve të mëposhtme:
  - 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
  - 1.2. Të kenë përgatitje adekuate profesionale; dhe
  - 1.3. Të jenë anëtar të Odës.
2. Kriteret për përkrahje të anëtarëve të OFTK-së pjesëmarrjes në aktivitete të EVP-së përfshijnë:
  - 2.1. Plotësimi e Aplikacionit për pjesëmarrje në aktivitetet e EVP-së në Shtojcën në formë elektronike, i nënshkruar dhe i dorëzuar të paktën 15 ditë para mbajtjes së aktivitetit; ndërsa për publikime deri në 15 ditë pas marrjes së konfirmimit;
  - 2.2 Aktiviteti për të cilin kërkohet përkrahja duhet të tregojë qartë relevancën e tematikës lidhur me të arritura në fushën e fizioterapisë;
  - 2.3. Kredibiliteti i aktivitetit, organizatorit dhe tematikës së aktivitetit për të cilin kërkohet përkrahja në pjesëmarrje;
  - 2.4 Roli i aplikuesit në aktivitet (duhet dëshmuar me dokument relevant) duhet të jetë:
    - Ligjërues apo autor i ftuar (vetëm autori i parë);
    - Pjesëmarrës me poster prezantim (vetëm autori i parë);
  - 2.5 Mundësia për të transmetuar përvojat dhe njohuritë e fituara nga pjesëmarrja në aktivitet. Aplikuesi duhet të ketë njohuri të gjuhës në të cilën mbahet aktiviteti.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

2.6 Aplikuesi duhet të pajiset me certifikatën për pjesëmarrje/ose me një dokument që dëshmon pjesëmarrjen në cilësinë e ftuar.

3. Mbështetja financiare për prezantimet me gojë (vetëm autori i prezantimit) janë si në vijim:
  - 3.1. Aktivitetet në të cilat OFTK-ja është organizatore, autori i prezantimit do të lirohen nga kuotizimet;
  - 3.2. Shtetet e regjionit të Ballkanit dhe Turqi, kuotizimet e pjesëmarrjes, deri në maksimum në shumën prej 200.00 euro;
  - 3.3. Shtetet e BE-së, deri në shumën prej 500.00 €.
  - 3.4. Shtetet jashtë BE-së (SHBA, Kanadë, Australi dhe vende tjera në të cilat organizimet konsiderohen me relevancë), deri në shumën prej 1,000.00 euro.
  - 3.5. Poster prezantimet përkrahen në shumën deri në 50 % nga paragrafi 3.2; 3.3 dhe 3.4. i këtij neni.
4. Anëtarët e OFTK-së kanë të drejtë vetëm një herë brenda 5 viteve të përfitojnë mbështetje financiare.
5. Të gjitha vendimet financiare nga neni 17 i kësaj Rregullore, caktohen në varshmëri prej buxhetit të aprovuar për EVP nga Kuvendi.

#### Neni 19

##### **Përgjegjësia e përfituesit dhe mbikëqyrja e aktivitetit nga Komisioni për EVP**

1. Anëtari i OFTK-së i cili ka përfituar nga përkrahja për pjesëmarrje në aktivitet, është i obliguar që në afat prej 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i eventit të sjellë raportin mbi pjesëmarrjen në aktivitet, duke i bashkëngjitur dokumentacionin i cili dëshmon pjesëmarrjen në aktivitet dhe shpenzimet e mbuluara
2. Nëse përfituesi nuk përmbushë detyrimin nga paragrafi 1 i këtij neni, të njëjtit do t'i caktohet ndalesa për të drejtën e aplikimit për përkrahje në aktivitete në EVP për një kohëzgjatje për 10 vite të ardhshme, lënda procedohet në Këshill Etik dhe OFTK do të iniciojë procedura për rimbursim të mjeteve të alokuara.
3. Vlerësimet dhe ndalesa eventuale e shqiptuar ndaj fizioterapeutit të cilit i është përkrahur pjesëmarrja në aktivitete të EVP-së, do të evidentohet në regjistrin për aktivitetet e EVP-së.
4. Me kërkesë të KEVP apo me kërkesën e autorit, të njëjtin punim, publikim, mund ta prezantojë në aktivitetet e OFTK-së.







Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

**KAPITULLI V - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

**Neni 20**

1. Pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje janë Shtojca për Vlerësim të Valorizimit të Pikëve Kredituese, Aplikacioni për Akreditimin e Aktiviteteve nga OFTK.
2. Çështjet nga fushë veprimtaria e KEVP -së, të cilat nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore, do procedohen në Këshillin Drejtues të OFTK-së, deri në plotësim – ndryshimin e saj.

**Neni 21**

**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi nga muaji Janar i vitit 2024.

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen të gjitha aktet e mëparshme që janë nga fushëveprimi i kësaj rregullore.

Prishtinë, 22.12.2023

Kryetari i OFTK-së.  
Ass.MSc. Feim Gashi,PT

